



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 106, Datë 10.07.2017**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJIA VALAMARA” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “MESMAL 1” ME FUQI TË INSTALUAR 410 KW; “MESMAL 2” ME FUQI TË INSTALUAR 1 473 KW; “MESMAL 3” ME FUQI TË INSTALUAR 235 KW; “SELCA 2” ME FUQI TË INSTALUAR 2 388 KW DHE ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 4 506 KW, PËR NJË AFAT 30 – VJEÇAR.**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

**Konstatoi se:**

- Aplikimi i shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat ( “a”, “b”, “c”, “f” dhe “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “b” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; dhe 4.1.4), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë më nenin 9, pika 2, gërmat “d” dhe “e”, nenin 9, pika 3, gërmat “a” dhe “c”, nenin 9, pika 4.1.5, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, neni 11, pika 1, t’i paraqesë ato në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për licencimin e Shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k., në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë nga HEC-et “Mesmal 1” me fuqi të instaluar 410 kW; “Mesmal 2” me fuqi të instaluar 1 473 kW; “Mesmal 3” me fuqi të instaluar 235 kW; “Selca 2” me fuqi të instaluar 2 388 kW dhe me fuqi totale të instaluar 4 506 kW.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**  
**Petrit AHMETI**